



**Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim**  
**Sektori për Bujqësi, Pylltari dhe zhvillim Rural**

## **THIRRJA PËR APLIKIM-SERRA**

### **I. Qëllimi i thirrjes për aplikim**

Qëllimi i thirrjes për aplikim është dhënia e mbështetjes financiare për investime në ferma në kuader të Projekteve në sektorin agro-rural sipas Pasqyrës buxhetore për vitin vijues 2014 në fushën e perimekulturës.

### **II. Përfituesit e pranueshëm**

Përfituesit e pranueshëm janë personat fizik-fermer. Ata duhet të jenë banor të përhershëm të Komunës së Prishtinës si dhe prona duhet të jetë në territorin e Komunës së Prishtinës .

### **III. Lloji i investimeve të pranueshme për sektorin e perimekulturës**

Ndërtimi i serrave të reja

- Tipi i serrës që mbështetet (përkrahet) është:
  - Serra e tipit “Tunel” nga polietileni, sipërfaqja prej 500 m<sup>2</sup>,
  - Serra e tipit “Blok” nga polietileni, sipërfaqja prej 500 m<sup>2</sup>

### **IV. Kriteret e përgjithshme të pranueshme**

- Përfituesit duhet të dorëzojnë kërkesën e plotësuar në formularin për aplikim, së bashku me dokumentet e bashkangjitura,
- Përfituesit të kenë të hapur llogari të vlefshme bankare,
- Toka në përdorim duhet të jetë në pronësi të përfituesve. Në rast të fermave familjare pronari i tokës mund të jetë fermeri ose të afërmit e tij/saj,
- Përparësi kanë aplikuesit të cilët dëshmojnë se kanë vijuar trajnime relevante/specifike në lëminë e Perimekulturës.
- Përparësi kanë fermerët e zonës ku është e zhvilluar perimekultura, përkatësisht fermerët që kanë mundsi të ujitjes.
- Aplikuesi-përfituesi nuk mund të jetë në mardhënje pune me Institucionin që bën përkrahjen .
- Nëse janë plotësuar në mënyrë të barabart kriteret e kërkuara aplikohet parimi “I pari vjen i pari shërbehet”.
- Fermerët duhet të posedojnë sipërfaqe të mjaftueshme të tokës bujqësore-minimum 2000 m<sup>2</sup> bllok në lokacionin ku ndërtohet serra.

## V. Kriteret specifike

- Fermerët duhet të investojnë në ngritjen (ndërtimin) e serrës së re në një sipërfaqe prej 500m<sup>2</sup>,
- Me rastin e blerjes të serrës të tipit - tunel është e pranueshme vetëm-serra e tipit - tunel nga polietileni, me dimensione së paku 8 x 62 x 4 = 496 m<sup>2</sup>,
- Me rastin e blerjes të serrës të tipit - "Bllok" është e pranueshme vetëm-serra e tipit Bllok nga polietileni me dimensione së paku 16 x 31 x 4=496m<sup>2</sup> ,14 x 35,5=497 m<sup>2</sup>
  
- Kushtet specifike për ndërtimin e serrës së re janë me niveli mesatar teknologjik:
  - Serra të jetë zhvendosese,
  - Hapja e themeleve duhet të jetë 60 x 60 x 45 cm,
  - Bazamenti duhet të jetë bërë nga shputa betoni dhe me një gyp (të diametrit Ø 6/4) i cili duhet vendosur në mes,
  - Bazamenti duhet të jetë i ndërtimi me gypa të zinkuar (me diametër Ø 5/4) gjatësia 2,4 m,
  - Mbushja e kapriateve (harku me perforcues) duhet të jetë me gypa të zinkuar (diametri Ø 3/4),
  - Pjesa e poshtme e kapriateve duhet të jetë me gypa të zinkuar (të diametrit Ø 1),
  - Harku i kapriateve duhet të jetë me gypa të zinkuar (të diametrit Ø 5/4),
  - Brinaket duhet të jenë me gypa të zinkuar (të diametrit Ø 3/4),
  - Shtangimet e ndërtimit (X-at) duhet të jenë me gypa të zinkuar (të diametrit Ø 3/4),
  - Dyert duhet të jene të vendosura në pjesën ballore,
  - Sistemi i ajrosjes në mënyrë mekanike, hapja e dritareve bëhet mekanikisht përmes gypave të zinkuar (të diametrit Ø 1/2) dhe të sforcuar me kapëse PVC 1/2,
  - Folia plastike duhet të jetë 160 µ (me garanci 3-5 vjet)

## VI.Koha dhe mënyra e pranimit të aplikacioneve

1. Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim është dita pasi të jetë publikuar thirrja për aplikim,
2. Thirrja për aplikim do të jete e hapur 15 ditë nga data e publikimit,
3. Investimi duhet të kryhet në afat prej 90 ditëve nga data e aprovimit të projektit, dhe të gjitha pagesat mbi shumën 500€ duhet të behën përmes transferit bankar,

## VII. Përzgjedhja dhe pagesat

1. Aplikimet kontrollohen, përzgjidhen dhe vlerësohen brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e fundit e dorëzimit të aplikacionit në kuadër të thirrjes aktuale për aplikim,
2. Pasi që aplikacioni të jetë kontrolluar sa i përket tërësisë dhe përshtatshmërisë verifikohet aplikacioni në terren,
3. Përfituesi do të pranojë një letër njoftuese për miratimin apo refuzimin e projektit (së bashku me arsyet),
4. Përfituesi duhet menjëherë të informoj për fillimin e investimit
5. Komuna e Prishtinës do të lidhë Marrëveshje me përfituesin e serrës i cili obligohet që të mos e bëjë tjetërsimin e serrës(shitje,dhënje në shfrytëzim etj.)

5. Pagesa do bëhet në dy faza :

- a) Pagesa parë(I-rë) do bëhet kur të jenë realizuar 50% e investimeve të planifikuara duke përfshirë edhe pjesmarrjen prej 23% të përfituesit-fermerit ,
- b).Pagesa e dytë(II-të) do bëhet kur të jenë realizuar tërësisht investimet e planifikuara Pagesat do bëhen pas vlerësimit të zyrtarëve të autorizuar për kryerjen e të gjitha aktiviteteve dhe investimeve të planifikuara.
- c) Vlera e përgjithshme e përkrahjesë do jet 10,000.00€ , ndërsa participimi i fermerit do jet 3,000.00€ , pra gjithsej vlera e projektit do jet 13,000.00€

## VII. Dokumentet e bashkangjitura

- Projekt propozimi me përshkrim të hollësishëm ;
  - a. përshkrimin e gjendjes në fermë,
  - b. qëllimin e investimeve dhe
  - c. koston e investimeve
- Një kopje e letërnjoftimit (LNJ) të vlefshme të Republikës së Kosovës
- Konfirmimin nga banka për xhironlogarin bankare të aplikuesit,
- Çertifikata mbi pronësinë e tokës së punueshme jo më e vjetër se 6 muaj
- Kopja e Planit të parcelës